



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1870/2 prot

Datë 01.08.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Salillari*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-69560-05-17-2023, me objekt “*Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)*”, me fond limit 86,870,520 (*tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK  
Adresa: Rruga “Asim Vokshi”, Pallati Alb Building Kt. 2, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë.

**Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “*Salillari*” SHPK  
Adresa: Rruga Vjetër Vorë, Marikaj, Km 1, Godina 4 katëshe, Kati i tretë, Nr. 5. Tiranë.

Në datën 31.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1870 prot, datë 31.07.2023 e operatorit ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK për procedurën e “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-69560-05-17-2023, me objekt “*Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)*”, me fond limit 86,870,520 (*tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “*Salillari*” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht:

Kapacitetin teknik pikwn 2.3.4; 2.3.5; 2.3.6

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e transportit)
- 1 (një) Inxhinier Mekanik / Elektrik / Elektronik

\*\*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

\* **Stafi teknik i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.**

**2.3.5** Operatori ekonomik, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Elektronik

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbleds të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së

afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**\* Staf i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- 1 (një) **ekspert zjarrfikës** me certifikatën përkatëse lëshuar nga Drejtoria e MZSH-së / licencë për mbrojtje nga zjarri të lëshuar nga QKL.

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**Stafi i kërkuar në pikën 2.3.6 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 01.08.2023.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**